- ç) transportin falas në vendin e caktuar të destinacionit, nëse udhëtari nuk ka nevojë të bëjë udhëtimin më tej;

d) kujdes dhe ndihmë për akomodim dhe ushqim, nëse kjo është e nevojshme për shkak të vonesës së shërbimit të hekurudhës.

2. Pavarësisht nëse ridrejtimi operohet nga e njëjta sipërmarrje hekurudhore apo një sipërmarrje tjetër kjo nuk do të sjellë kosto shtesë për udhëtarin. Kjo kërkesë zbatohet gjithashtu kur ridrejtimi përfshin përdorimin e transportit të një klase shërbimi më të lartë dhe mënyrave alternative të transportit.

a) Sipërmarrjet hekurudhore bëjnë përpjekje të arsyeshme të shmangin udhëtimet shtesë dhe sigurojnë që vonesa në kohën totale të udhëtimit të jetë sa më e shkurtër e mundur.

b) Udhëtarët nuk zbresin në mjetet e transportit të një klase më të ulët, përveç rasteve kur këto lehtësira janë të vetmet mjete të disponueshme të ridrejtitimit.

3. Pa paragjykuar paragrafin 2, sipërmarrja hekurudhore lejon udhëtarin, me kërkesën e tij ose të saj, të lidhë kontrata me ofrues të tjerë të shërbimeve të transportit, të cilat i mundësojnë të arrijë në destinacionin përfundimtar në kushte të krahasueshme, rast në të cilin sipërmarrja hekurudhore rimbursos udhëtarin për shpenzimet që ai ose ajo ka.

a) Kur opsionet e disponueshme të ridrejtitimit nuk i komunikohen udhëtarit brenda 100 minutave nga koha e planifikuar e nisjes së shërbimit të vonuar ose të anuluar ose udhëtimit të humbur, udhëtari ka të drejtë të lidhë një kontratë të tillë me ofrues të tjerë të shërbimeve të transportit publik me hekurudhë ose me autobus. Sipërmarrja hekurudhore i rimbursos udhëtarit shpenzimet e nevojshme, të përshtatshme dhe të arsyeshme që ai ose ajo ka.

b) Ky paragraf nuk do të ndikojë në ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative kombëtare që u japin udhëtarëve kushte më të favorshme të ridrejtitimit.

4. Ofruesit e shërbimeve të transportit të ridrejtitimit u ofrojnë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar një nivel të krahasueshëm ndihme dhe aksesueshmëri, shërbime alternative që janë të përshtatshme për nevojat e tyre dhe që ndryshojnë nga ato që u ofrohen udhëtarëve të tjerë.

5. Rimbursimet e përmendura në pikën “b” të paragrafit 1 dhe në paragrafin 3 paguhen brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës. Sipërmarrjet hekurudhore pranojnë kërkesa të tilla me mjete të veçanta komunikimi, me kusht që kërkesa të mos krijojë efekte diskriminuese.

a) Rimbursimi mund të marrë formën e kuponëve dhe/ose të ofrimit të shërbimeve të tjera me kusht që kushtet e këtyre kuponëve dhe/ose shërbimeve të jenë mjaft fleksibël, veçanërisht në lidhje me periudhën e vlefshmërisë dhe destinacionin, dhe që udhëtari të pranojë ato kuponë dhe/ose shërbime.

b) Rimbursimi i çmimit të biletës nuk reduktohet nga kostot e transaksionit financiar si tarifat, kostot e telefonit apo pullat.

6. Kërkesa për rimbursim bëhet sipas formularit të dhënë nga sipërmarrja hekurudhore në një format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar.

7. Udhëtarët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre, duke përdorur formularin e përmendur në paragrafin 6. Sipërmarrjet hekurudhore nuk refuzojnë një kërkesë për rimbursim vetëm me arsyetimin se udhëtari nuk e ka përdorur atë formular. Nëse një kërkesë nuk është mjaftueshëm e saktë, sipërmarrja hekurudhore i kërkon udhëtarit të plotësojë kërkesën dhe e ndihmon udhëtarin për ta bërë këtë.

Neni 20

Kompensimi

1. Pa humbur të drejtën e transportit, një udhëtar ka të drejtën e kompensimit për vonesat nga sipërmarrja hekurudhore, nëse ai ose ajo përballet me një vonesë midis vendeve të nisjes dhe

destinacionit përfundimtar të shënuar në biletë ose në biletë për të cilën kosto nuk është rimbursuar, në përputhje me nenin 19. Kompensimi minimal për vonesat do të jetë si më poshtë:

- a) 25% e çmimit të biletës për një vonesë prej 60 deri në 119 minutash;
- b) 50% e çmimit të biletës për një vonesë prej 120 minutash ose më shumë.

2. Paragrafi 1 zbatohet edhe për udhëtarët që përdorin abone. Nëse këta udhëtarë hasin vonesa ose anulime të përsëritura gjatë periudhës së vlefshmërisë së abonesë, ata kanë të drejtën e kompensimit të përshtatshëm, në përputhje me marrëveshjet e kompensimit të sipërmarrjes hekurudhore:

a) këto rregullime përcaktojnë kriteret për përcaktimin e vonesës dhe për llogaritjen e kompensimit;

b) kur vonesat më pak se 60 minuta ndodhin në mënyrë të përsëritur gjatë periudhës së vlefshmërisë së abonesë, vonesat numërohen në mënyrë kumulative dhe udhëtarët kompensohen në përputhje me marrëveshjet e kompensimit të sipërmarrjes hekurudhore.

3. Pa cenuar paragrafin 2, kompensimi për vonesën llogaritet në lidhje me çmimin e plotë që udhëtarë ka paguar realisht për shërbimin e vonuar:

a) kur kontrata e transportit është për një udhëtim kthimi, kompensimi për vonesën në pjesën e jashtme ose të kthimit llogaritet në lidhje me çmimin e treguar për atë pjesë të udhëtimit në biletë.

b) kur nuk ka një tregues të tillë të çmimit të pjesëve individuale të udhëtimit, kompensimi llogaritet në lidhje me gjysmën e çmimit të paguar për biletën;

c) në të njëjtën mënyrë, çmimi për një shërbim me vonesë të ofruar sipas çdo forme tjetër të kontratës së transportit llogaritet në proporcion me çmimin e plotë.

4. Llogaritja e periudhës së vonesës nuk merr parasysh asnjë vonesë që sipërmarrja hekurudhore demonstroi se ka ndodhur jashtë vendit.

5. Kërkesa për kompensim bëhet sipas formularit të dhënë nga sipërmarrja hekurudhore në një format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar.

6. Udhëtarët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre, duke përdorur formularin e përmendur në paragrafin 5. Sipërmarrjet hekurudhore nuk refuzojnë një kërkesë për kompensim vetëm me arsyetimin se udhëtarë nuk e ka përdorur atë formular. Nëse një kërkesë nuk është mjaftueshëm e saktë, sipërmarrja hekurudhore i kërkon udhëtarit të plotësojë kërkesën dhe e ndihmon udhëtarin për ta bërë këtë.

7. Kompensimi i çmimit të biletës paguhet brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim. Kompensimi mund të paguhet në kuponë dhe/ose shërbime të tjera nëse kushtet janë të pranueshme, veçanërisht në lidhje me periudhën e vlefshmërisë dhe destinacionin.

a) Kompensimi paguhet në të holla me kërkesë të udhëtarit.

8. Kompensimi i çmimit të biletës nuk zvogëlohet nga kostot e transaksionit financiar si tarifat, kostot e telefonit apo pullat. Sipërmarrjet hekurudhore vendosin një prag minimal nën të cilin nuk do të paguhet pagesat për kompensim. Ky prag nuk duhet të kalojë 4 euro për biletë.

9. Udhëtarët nuk kanë asnjë të drejtë kompensimi nëse informohen për një vonesë përpara se të blejnë një biletë, ose nëse vonesa për shkak të vazhdimit të një shërbimi tjetër ose ridrejtimit mbetet nën 60 minuta.

10. Sipërmarrja hekurudhore nuk është e detyruar të paguajë dëmshpërblim nëse mund të provojë se vonesa, udhëtimi i humbur ose anulimi është shkaktuar drejtpërdrejt ose ka qenë e lidhur në thelb me:

a) rrethana të jashtëzakonshme që nuk lidhen me funksionimin e hekurudhës, si kushtet ekstreme të motit, fatkeqësitë e mëdha natyrore ose krizat e mëdha të shëndetit publik, të cilat sipërmarrja hekurudhore, pavarësisht se kishte marrë kujdesin e kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk ishte në gjendje ta shmangte dhe pasojat e të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte;

b) faji i udhëtarit; ose

c) sjelljen e një pale të tretë, të cilën sipërmarrja hekurudhore, pavarësisht se kishte marrë kujdesin e kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk ishte në gjendje ta shmangte dhe pasojat e

të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte, si p.sh. persona në binarë, vjedhje kabllosh, emergjenca në tren, aktivitete të zbatimit të ligjit, sabotim ose terrorizëm.

d) Grevat nga personeli i sipërmarrjes hekurudhore, veprimet ose mosveprimet nga një sipërmarrje tjetër që përdor të njëjtën infrastrukturë hekurudhore dhe veprimet ose mosveprimet e administratorëve të infrastrukturës dhe stacioneve nuk mbulohen nga përjashtimi i përmendur në pikën "c" të nënparagrafit të parë.

Neni 21

Ndihma në rast vonesash

1. Në rast të një vonese në mbërritje ose në nisje, ose anulim të një udhëtimit, udhëtarët informohen për situatën dhe për kohën e parashikuar të nisjes dhe kohën e parashikuar të mbërritjes ose të shërbimit të zëvendësimit nga sipërmarrja hekurudhore ose nga administratori i stacionit, sapo të jetë i disponueshëm një informacion i tillë.

a) Kur shitësit e biletave dhe operatorët turistikë kanë një informacion të tillë, ata gjithashtu ia japin atë udhëtarit.

2. Kur vonesa e përmendur në paragrafin 1 arrin në 60 minuta ose më shumë, ose udhëtimit anulohet, sipërmarrja hekurudhore u ofron udhëtarëve pa pagesë:

a) vaktet dhe pijet freskuese, në lidhje të arsyeshme me kohën e pritjes, nëse ato janë të disponueshme në tren ose në stacion, ose mund të ofrohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh kriteret e tilla, si: distanca nga furnizuesi, koha e nevojshme për dorëzim dhe kostoja;

b) hotel ose akomodim tjetër dhe transport ndërmjet stacionit hekurudhor dhe vendit të akomodimit, në rastet kur bëhet i nevojshëm qëndrimi për një ose më shumë net ose bëhet i nevojshëm një qëndrim shtesë, ku dhe kur është e mundur fizikisht.

c) Në rastet kur një qëndrim i tillë bëhet i nevojshëm për shkak të rrethanave të përmendura në pikën 10 të nenit 20, sipërmarrja hekurudhore kufizon kohëzgjatjen e akomodimit në maksimum tri net.

ç) Kërkesat për akses të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar dhe nevojat e qenve ndihmës do të merren parasysh, kurdoherë që është e mundur;

d) nëse treni është i bllokuar në shina, transporti nga treni në stacionin hekurudhor, në pikën alternative të nisjes ose në destinacionin përfundimtar të shërbimit, ku dhe kur është e mundur fizikisht.

3. Nëse shërbimi hekurudhor ndërpritet dhe nuk mund të vazhdojë më ose nuk mund të vazhdojë brenda një periudhe të arsyeshme, sipërmarrjet hekurudhore u ofrojnë udhëtarëve sa më shpejt të jetë e mundur shërbime alternative të transportit.

4. Sipërmarrjet hekurudhore informojnë udhëtarët se si të kërkojnë vërtetimin se shërbimi hekurudhor ka pësuar një vonesë, ka çuar në një udhëtim të humbur ose se është anuluar. Ky vërtetim do të zbatohet edhe në lidhje me dispozitat e parashikuara në nenin 20.

5. Në zbatimin e paragrafëve 1 deri në 4, sipërmarrja hekurudhore u kushton vëmendje të veçantë nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar, si dhe atyre të çdo personi shoqërues dhe qenve ndihmës.

6. Kur hartohen planet e emergjencës sipërmarrjet hekurudhore koordinojnë me administratorin e stacionit dhe administratorin e infrastrukturës për mundësinë e ndërprerjeve të mëdha dhe vonesave të gjata që sjellin qëndrimin në stacion të një numri të konsiderueshëm udhëtarësh. Plane të tilla emergjence përfshijnë kërkesat për aksesueshmërinë e sistemeve të alarmit dhe informacionit.

KREU VI

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PERSONA ME LËVIZSHMËRI TË REDUKTUAR

Neni 22

Ndihma në stacionet hekurudhore dhe në tren

1. Personat me aftësi të kufizuara ose personat me lëvizshmëri të reduktuar do të asistohen si më poshtë:

a) asistenti personal, i njohur si i tillë në përputhje me praktikat kombëtare, mund të udhëtojë me një tarifë të veçantë dhe, nëse është e mundur, pa pagesë dhe të ulet, kur është e mundur, pranë personit me aftësi të kufizuara;

b) kur një sipërmarrje hekurudhore kërkon që një udhëtar duhet të shoqërohet në tren, personi shoqërues ka të drejtë të udhëtojë pa pagesë dhe të ulet, kur është e mundur, pranë personit me aftësi të kufizuara ose te personi me lëvizshmëri të reduktuar;

c) një qen ndihmës lejohet t'i shoqërojë ata në përputhje me çdo ligj kombëtar përkatës;

ç) për trenat pa personel, administratorët e stacioneve ose sipërmarrjet hekurudhore ofrojnë ndihmë pa pagesë, gjatë hipjes dhe zbritjes nga një tren kur ka staf të trajnuar në detyrë në stacion;

d) me nisjen, kalimin tranzit ose mbërritjen në një stacion hekurudhor me staf, administratorët e stacioneve ose sipërmarrjet hekurudhore ofrojnë ndihmë pa pagesë, në mënyrë të tillë që ai person të jetë në gjendje të hipë në tren, të transferohet në një shërbim hekurudhor lidhës për të cilin ai ose ajo ka një biletë, ose të zbresë nga treni, me kusht që të ketë staf të trajnuar në detyrë.

dh) Kur nevoja për ndihmë është njoftuar paraprakisht në përputhje me nenin 23, pika "a", administratorët e stacioneve ose sipërmarrjet hekurudhore sigurojnë që ndihma të ofrohet siç kërkohet;

e) në stacionet pa personel, sipërmarrjet hekurudhore ofrojnë ndihmë pa pagesë në tren dhe gjatë hipjes dhe zbritjes nga treni nëse treni shoqërohet nga personel i trajnuar;

ç) në mungesë të personelit shoqërues të trajnuar në bordin e një treni dhe në një stacion, administratorët e stacioneve ose sipërmarrjet hekurudhore bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara ose personave me lëvizshmëri të reduktuar të kenë akses për të udhëtuar me hekurudhë;

f) sipërmarrjet hekurudhore bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të sigurojnë për personat me aftësi të kufizuara ose personave me lëvizshmëri të reduktuar, akses në të njëjtat shërbime në tren si udhëtarët e tjerë, kur këta persona nuk mund të kenë akses në këto shërbime në mënyrë të pavarur dhe të sigurt.

g) rregullat e përmendura në pikën 1, të nenit 97, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", përcaktojnë masat për ushtrimin e të drejtave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 23

Kushtet në të cilat ofrohet ndihma

Sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e stacioneve, shitësit e biletave dhe operatorët turistikë bashkëpunojnë për të ofruar ndihmë falas për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, duke ofruar një mekanizëm të vetëm njoftimi, në përputhje me sa vijon pika:

a) ndihma ofrohet me kusht që sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e stacioneve, shitësi i biletave ose operatori turistik me të cilin është blerë bileta, ose pika e vetme e kontaktit e përmendur në shkronjën "dh" të këtij neni, aty ku është e zbatueshme, të njoftohet për nevojat e udhëtarit për një ndihmë të tillë të paktën 24 orë përpara se të nevojitet ndihma;

b) një njoftim i vetëm për udhëtim është i mjaftueshëm dhe i përcillet të gjitha sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të stacioneve të përfshira në udhëtim, të cilin e pranojnë pa kosto shtesë, pavarësisht nga mjetet e komunikimit që përdoren;

c) kur një biletë lejon udhëtime të shumëfishta, një njoftim është i mjaftueshëm me kusht që të jepet informacioni i duhur për kohën e udhëtimeve të mëvonshme dhe në çdo rast të paktën 24 orë përpara herës së parë që nevojitet ndihma;

ç) udhëtari ose përfaqësuesi i tij/saj bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme të informojë për çdo anulim të këtyre udhëtimeve të mëvonshme të paktën 12 orë përpara;

d) sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e stacioneve, shitësit e biletave dhe operatorët turistikë marrin të gjitha masat e nevojshme për marrjen e njoftimeve. Kur shitësit e biletave nuk janë në gjendje të përpunojnë njoftime të tilla, ata tregojnë pikat alternative të blerjes ose mjetet alternative për të bërë njoftimin;

dh) nëse nuk bëhet asnjë njoftim në përputhje me shkronjën “a”, sipërmarrja hekurudhore dhe administratori i stacionit bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme të ofrojnë ndihmë në mënyrë të tillë që personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të reduktuar të udhëtojë normal;

e) pa cenuar pikën “g” të këtij neni, administratori i stacionit ose çdo person tjetër i autorizuar cakton pikat në të cilat personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar mund të bëjnë të ditur mbërritjen e tyre në stacionin hekurudhor dhe të kërkojnë ndihmë;

ë) ndihma ofrohet me kusht që personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të reduktuar të paraqitet në pikën e caktuar në një kohë të caktuar nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i stacionit që ofron këtë ndihmë;

f) çdo kohë e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 60 minuta përpara orës së publikuar të nisjes ose kohës në të cilën të gjithë udhëtarëve u kërkohet të bëjnë *check-in* vetë, personi duhet të paraqitet në pikën e caktuar të paktën 30 minuta përpara orës së publikuar të nisjes ose përpara kohës në të cilën të gjithë udhëtarëve u kërkohet të bëjnë *check-in*;

g) sipërmarrja hekurudhore dhe administratori i stacionit në territorin e tyre bashkëpunojnë të krijojnë dhe të funksionojnë pika të vetme kontakti për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar. Këto pika të vetme kontakti kanë përgjegjësinë, për:

- i. pranimin e kërkesave për ndihmë në stacione;
- ii. komunikimin e kërkesave individuale për ndihmë administratorëve të stacioneve dhe sipërmarrjeve hekurudhore; dhe
- iii. ofrimin e informacioneve mbi aksesueshmërinë.

Neni 24

Kompensimi në lidhje me pajisjet e lëvizshmërisë, pajisjet ndihmëse dhe qentë ndihmës

1. Kur sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve shkaktojnë humbjen ose dëmtimin e pajisjeve të lëvizshmërisë, duke përfshirë karriget me rrota dhe pajisjet ndihmëse, ose humbjen ose lëndimin e qenve ndihmës të përdorur nga personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, ata janë përgjegjës për atë humbje, dëmtim ose lëndim dhe sigurojnë kompensim pa vonesa të panevojshme. Ky kompensim përfshin:

a) koston e zëvendësimit ose të riparimit të pajisjeve të lëvizshmërisë ose të pajisjeve ndihmëse të humbura ose të dëmtuara;

b) koston e zëvendësimit ose të trajtimit të lëndimit të një qeni ndihmës që ka humbur ose plagosur; dhe

c) kostot e arsyeshme të zëvendësimit të përkohshëm për pajisjet e lëvizshmërisë, pajisjet ndihmëse ose qentë ndihmës, kur një zëvendësim i tillë nuk ofrohet nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve në përputhje me paragrafin 2.

2. Kur zbatohet paragrafi 1, sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve bëjnë menjëherë të gjitha përpjekjet e arsyeshme të sigurojnë zëvendësimet e përkohshme të nevojshme për pajisjet e lëvizshmërisë ose pajisjet ndihmëse. Personi me aftësi të kufizuara ose personi me lëvizshmëri të reduktuar lejohet të mbajë atë pajisje ose pajisje zëvendësuese të përkohshme derisa të jetë paguar kompensimi i përmendur në paragrafin 1.

Neni 25

Trajnimi i stafit

1. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve sigurojnë që i gjithë personeli që ka funksion ofrimin e ndihmës të drejtpërdrejtë për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, të marrin trajnime në lidhje në mënyrë që të dinë se si të përmbushin nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar.

2. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve i sigurojnë të gjithë personelit, që punon në stacione ose në trena, i cili merret drejtpërdrejt me udhëtarët, trajnime dhe kurse trajnimi të rregullta rifreskuese për të rritur ndërgjegjësimin për nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar.

3. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve lejojnë pjesëmarrjen, në trajnimin e përmendur në paragrafin 1, të punonjësve me aftësi të kufizuara dhe mund të marrin në konsideratë pjesëmarrjen e udhëtarëve me aftësi të kufizuara dhe me lëvizshmëri të reduktuar dhe/ose organizatave që i përfaqësojnë ata.

KREU VII ANKESAT DHE TRAJTIMI I TYRE

Neni 26 **Ankesat**

Në vijim të nenit 100, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, janë përcaktimet:

a) Çdo sipërmarrje hekurudhore dhe administrator stacioni krijojnë një mekanizëm për trajtimin e ankesave për të drejtat dhe detyrimet e mbuluara nga ky udhëzim në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Ata duhet t’u bëjnë të njohura gjerësisht udhëtarëve detajet e kontaktit dhe gjuhën e përdorur. Ky mekanizëm nuk do të zbatohet për qëllimet e kreut IV.

b) Udhëtarët i paraqesin një ankesë sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të stacionit në lidhje me fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë nëpërmjet mekanizmave të përmendur në paragrafin “a”. Një ankesë e tillë dorëzohet brenda tre muajve nga incidenti që ka ndodhur.

c) Brenda një muaji nga marrja e ankesës, marrësi ose duhet të japë një përgjigje të arsyetuar ose, në raste të justifikuara, të informojë udhëtarin se ai ose ajo do të marrë një përgjigje brenda një periudhe më pak se tre muaj nga data e marrjes së ankesës.

ç) Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e stacioneve mbajnë të dhënat e nevojshme për të vlerësuar ankesën për kohëzgjatjen e të gjithë procedurës së trajtimit të ankesës, duke përfshirë procedurat e trajtimit të ankesave të përmendura në nenin 33 dhe në nenin 57, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe i vënë ato të dhëna të disponueshme për organet kombëtare të shqyrtimit sipas ligjeve në fuqi.

d) Detajet e procedurës së trajtimit të ankesave duhet të jenë të disponueshme për publikun, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar. Ky informacion është i disponueshëm të paktën në gjuhën zyrtare, me të cilën sipërmarrja hekurudhore operon.

dh) Sipërmarrja hekurudhore publikon në raportin e përmendur në nenin 101, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, numrin dhe kategoritë e ankesave të pranuar dhe të ankesave të përpunuara, kohën e përgjigjes dhe veprimet e mundshme të përmirësimit të ndërmarra.

Neni 27

Trajtimi i ankesave nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor

1. Pa cenuar të drejtat e konsumatorëve për të kërkuar kompensim alternativ, pasi të jetë ankuar pa sukses të sipërmarrja hekurudhore ose administratori stacionit në përputhje me nenin 26, udhëtarë mund të ankohet tek Autoriteti Rregullator Hekurudhor brenda tre muajve nga marrja e

informacionit për refuzimin e ankesës. Ai organ informon ankuesin për të drejtën e tij ose të saj për t'u ankuar tek organet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

2. Çdo udhëtar mund të ankohet për një shkellje të pretenduar të këtij udhëzimi te Autoriteti Rregullator Hekurudhor.

3. Autoriteti Rregullator Hekurudhor konfirmon marrjen e ankesës brenda dy javësh nga marrja e saj. Procedura e trajtimit të ankesës zgjat maksimumi tre muaj nga data e krijimit të dosjes së ankesës ose për raste komplekse, zgjat deri në gjashtë muaj. Në rast zgjatjeje, informohet udhëtari për arsyet e zgjatjes dhe për kohën e pritshme të nevojshme për përfundimin e procedurës. Vetëm ato raste që përfshijnë procedura ligjore mund të zgjasin më shumë se gjashtë muaj.

4. Procedura e trajtimit të ankesave bëhet e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat me lëvizshmëri të reduktuar.

KREU VIII RREGULLAT E KONKURRENCËS

Neni 28

Zbatimi i rregullave të konkurrencës në sektorin hekurudhor

1. Rregullat e konkurrencës të dhëna në këtë udhëzim zbatohen për të gjitha marrëveshjet, vendimet dhe praktikatat e bashkërenduara që kanë si objekt ose efekt përcaktimin e tarifave dhe kushteve të transportit, kufizimin ose kontrollin e furnizimit të transportit, ndarjen e tregjeve të transportit, aplikimin e përmirësimeve teknike ose bashkëpunimin teknik, ose financimin ose blerjen e përbashkët të pajisjeve ose furnizimeve të transportit, kur operacione të tilla lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor dhe janë të nevojshme për funksionimin e përbashkët të shërbimeve dhe abuzimin me pozitën dominuese në tregun e transportit.

2. Këto dispozita zbatohen, gjithashtu, për operacionet e ofruesve të shërbimeve ndihmëse të transportit hekurudhor që kanë ndonjë nga këto objekte ose efekte.

Neni 29

Përrjashtim për marrëveshjet teknike

1. Ndalimet e parashikuara që kanë si objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës nuk zbatohen për marrëveshjet, vendimet ose praktikatat e bashkërenduara, objekti dhe efekti i të cilave është zbatimi i përmirësimeve teknike ose arritja e bashkëpunimit teknik me anë të:

a) standardizimit të pajisjeve, furnizimeve të transportit, mjeteve hekurudhore ose instalimeve fikse;

b) shkëmbimi ose bashkimi, me qëllim të funksionimit të shërbimeve të transportit, të personelit, pajisjeve, mjeteve hekurudhore ose instalimeve fikse;

c) organizimin dhe ekzekutimin e operacioneve të transportit të njëpasnjëshëm, plotësues, zëvendësues ose të kombinuar, si dhe caktimin dhe zbatimin e tarifave dhe kushteve gjithëpërfshirëse për operacione të tilla, duke përfshirë tarifatat e veçanta konkurruese;

ç) përdorimin, për udhëtime me një mënyrë të vetme transporti, të rrugëve që janë më racionale nga pikëpamja operative;

d) koordinimi i orarit të transportit për linjat lidhëse;

dh) grupimi i dërgesave të vetme;

e) vendosjen e rregullave uniforme për strukturën e tarifave dhe kushtet e zbatimit të tyre, me kusht që këto rregulla të mos përcaktojnë tarifatat dhe kushtet e transportit.

2. Sipas rastit, për të zgjeruar ose reduktuar listën në paragrafin 1 bëhen propozime shtesë nga organet ligjore të konkurrencës.

KREU IX DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 30

Periudha tranzitore

1. Kontratat e shërbimeve publike për transportin publik të udhëtarëve me hekurudhë, do të jepen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Dhënia e kontratave të shërbimit publik për transportin e udhëtarëve me hekurudhë në përputhje me nenin 6, pika 6 të dhe nenin 8, pika 3 të pushojnë së zbatuari nga 25 dhjetori 2023.

3. Kontratat e shërbimit publik për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë, të dhëna drejtpërdrejt mbi bazën e një procedure të ndryshme nga një procedurë konkurruese e drejtë, të vazhdojnë deri në datën e skadimit të tyre.

4. Autoriteti kompetent ka të drejtën të përjashtojë nga procesi i dhënies së kontratave me ftesë për tender operatorët e shërbimeve publike, që nuk mund të provojnë se shërbimet e tyre përfaqësojnë të paktën gjysmën e vlerës së të gjitha shërbimeve të transportit publik, për të cilat ata marrin kompensim ose gëzojnë të drejtë ekskluzive. Nëse autoriteti kompetent vendos të përdorë këtë opsion, e zhvillon pa diskriminim dhe informon operatorët e mundshëm në fillim të procedurës për dhënien e kontratave njëkohësisht edhe Komisionin, të paktën dy muaj para publikimit të ftesës për tender.

5. Kompensimi i shërbimit publik për funksionimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve ose për përmbushjen e detyrimeve tarifore të përcaktuara nëpërmjet rregullave të përgjithshme të paguara në përputhje me këtë udhëzim do të jetë në përputhje me tregun.

6. Ndhimja për sektorin e transportit nga shteti do të vazhdojë që të plotësojë nevojat e koordinimit të transportit ose që përfaqëson rimbursimin për përmbushjen e disa detyrimeve të qenësishme në konceptin e një shërbimi publik, përveç atyre që mbulohen nga ky udhëzim, dhe në veçanti:

a) deri në hyrjen në fuqi të rregullave të përbashkëta për shpërndarjen e kostove të infrastrukturës, ku ndihma u jepet sipërmarrjeve që duhet të përballojnë shpenzimet në lidhje me infrastrukturën e përdorur prej tyre, ndërsa sipërmarrjet e tjera nuk i nënshtrohen një barre të ngjashme. Në përcaktimin e shumës së ndihmës së dhënë, do të merren parasysh kostot e infrastrukturës që nuk duhet të përballojnë mënyrat konkurruese të transportit;

b) ku qëllimi i ndihmës është të promovojë kërkimin ose zhvillimin e sistemeve dhe të teknologjive të transportit që janë më ekonomike në përgjithësi.

7. Një ndihmë e tillë do të kufizohet në fazën e kërkimit dhe të zhvillimit dhe nuk mund të mbulojë shfrytëzimin komercial të sistemeve dhe teknologjive të tilla të transportit.

Neni 31

Ndëshkimet

1. Organi kompetent përcakton rregullat për ndëshkimet që jepen për shkeljet e këtij udhëzimi dhe merr të gjitha masat e nevojshme të sigurojë zbatimin e tyre. Ndëshkimet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse. Organi kompetent njofton Komisionin për këto rregulla dhe masa, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të tyre.

2. Organi kompetent trajton ankesën, investigon shkeljen e këtij udhëzimi dhe, nëse është e nevojshme, vendos gjoba.

Neni 32

Autoritetet zbatuese

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rregullator Hekurudhor dhe sipërmarrësit hekurudhor.

Neni 33
Dispozita të fundit

Udhëzimi i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 10, datë 9.7.2012, “Mbi rregullat në transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve”, shfuqizohet.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI I
RREGULLAT PËR KOMPENSIMIN

1. Kompensimi i lidhur me kontratat e shërbimeve publike të dhëna drejtpërdrejt në përputhje me nenin 6, pikat 2, 4, 5 dhe 6 ose me një rregull të përgjithshëm llogariten në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë aneks.

2. Kompensimi nuk mund të kalojë një shumë që korrespondon me efektin financiar neto ekuivalent me totalin e efekteve, pozitive ose negative, të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik mbi kostot dhe të ardhurat e operatorit të shërbimit publik. Efektet do të vlerësohen duke krahasuar situatën ku përmbushet detyrimi i shërbimit publik me situatën që do të kishte ekzistuar nëse detyrimi nuk do të ishte përmbushur.

Për të llogaritur efektin financiar neto, autoriteti kompetent udhëhiqet nga skema e mëposhtme:

- kostot e bëra në lidhje me një detyrim shërbimi publik ose një grup detyrimesh shërbimi publik të vendosura nga autoriteti kompetent, të përfshira në një kontratë shërbimi publik dhe/ose në një rregull të përgjithshëm;

- minus çdo efekt financiar pozitiv të gjeneruar brenda rrjetit të operuar, sipas detyrimeve të shërbimit publik në fjalë;

- minus arkëtimet nga tarifatat ose çdo të ardhur tjetër të krijuar gjatë përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik në fjalë;

+ plus një fitim të arsyeshëm;

është e barabartë me efektin financiar neto.

3. Pajtueshmëria me detyrimin e shërbimit publik mund të ketë ndikim në aktivitetet e mundshme të transportit të një operatori përtej detyrimit/ve të shërbimit publik në fjalë. Për të shmangur mbikompensimin ose mungesën e kompensimit, efektet financiare të matshme në rrjetet e operatorit në fjalë merren parasysh si rrjedhim gjatë llogaritjes së efektit financiar neto.

4. Kostot dhe të ardhurat llogariten në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe të taksave në fuqi.

5. Për të rritur transparencën dhe për të shmangur ndërsubvencionet, ku një operator i shërbimeve publike, jo vetëm që operon shërbime të kompensuara, që u nënshtrohen detyrimeve të shërbimit të transportit publik, por gjithashtu angazhohet në aktivitete të tjera, llogaritë e këtyre shërbimeve publike ndahen në mënyrë që të plotësohen paktën kushtet e mëposhtme:

- llogaritë operative që i korrespondojnë secilit prej këtyre aktiviteteve duhet të jenë të ndara dhe proporcioni i aktiveve përkatëse dhe i kostove fikse të shpërndahen në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe taksave në fuqi;

- të gjitha kostot variabile, një kontribut i përshtatshëm në kostot fikse dhe një fitim i arsyeshëm i lidhur me çdo aktivitet tjetër të operatorit të shërbimit publik, në asnjë rrethanë nuk mund t'i ngarkohen shërbimit publik në fjalë;

- kostot e shërbimit publik të balancohen nga të ardhurat operative dhe pagesat nga autoritetet publike, pa asnjë mundësi transferimi të të ardhurave në një sektor tjetër të veprimtarisë së operatorit të shërbimit publik.

6. Fitimi i arsyeshëm merret si një normë kthimi mbi kapitalin që është normale për sektorin dhe që merr parasysh rrezikun ose mungesën e rrezikut të shkaktuar nga operatori i shërbimit publik.

7. Metoda e kompensimit duhet të nxisë mirëmbajtjen ose zhvillimin e:

- menaxhimit efektiv nga operatori i shërbimit publik, i cili mund të jetë objekt i një vlerësimi objektiv; dhe

- ofrimi i shërbimeve të transportit të udhëtarëve të një standardi mjaft të lartë.

ANEKSI II

EKSTRAKT NGA RREGULLAT UNIFORME LIDHUR ME KONTRATËN PËR TRAJTIM NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE DHE BAGAZHEVE ME HEKURUDHA (CIV)

Shtojca A e Konventës në lidhje me transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) e datës 9 maj 1980, e modifikuar nga Protokollin për modifikimin e Konventës, në lidhje me transportin ndërkombëtar hekurudhor të datës 3 qershor 1999

TITULLI I

EKZEKUTIMI I KONTRATËS SË TRANSPORTIT

Neni 1

Kontrata e transportit

1. Me kontratën e transportit, transportuesi merr përsipër të transportojë udhëtarin, si dhe, sipas rastit, bagazhet dhe automjetet dhe të dorëzojë ato në vendin e destinacionit.

2. Kontrata e transportit konfirmohet me një ose më shumë bileta të lëshuara për udhëtarin. Megjithatë, mungesa, parregullsia ose humbja e biletës nuk do të ndikojë në ekzistencën ose vlefshmërinë e kontratës, e cila mbetet subjekt i këtyre rregullave.

3. Bileta është provë e lidhjes dhe përmbajtjes së kontratës së transportit.

Neni 2

Bileta

1. Organi kompetent përcakton formën dhe përmbajtjen e biletave, si dhe gjuhën dhe karakteret në të cilat përgatiten dhe printohen.

2. Bileta përmban të paktën sa më poshtë:

a) transportuesin ose transportuesit;

b) stacionin e nisjes dhe të mbërritjes;

c) itinerarin; nëse lejohet përdorimi i itinerareve të ndryshme ose i mjeteve të ndryshme, kjo mundësi duhet të shënohet;

ç) kategorinë e trenit dhe klasën e vagonit;

d) çmimin e transportit;

dh) ditën e parë të vlefshmërisë;

e) kohëzgjatjen e vlefshmërisë.

3. Udhëtari, pas marrjes së biletës, duhet të sigurohet që bileta është plotësuar në përputhje me treguesit e saj.

4. Bileta është e transferueshme nëse nuk është bërë në emër të udhëtarit dhe nëse udhëtimi nuk ka filluar.

5. Bileta vendoset edhe në formën e regjistrimit elektronik të të dhënave, të cilat mund të shndërrohen në simbole të shkruara të lexueshme. Procedura e përdorur për regjistrimin dhe trajtimin e të dhënave të jetë ekuivalente nga pikëpamja funksionale, veçanërisht për sa i përket vlerës provuese të biletës që përfaqësohet nga këto të dhëna.

Neni 3

Pagesa dhe rimbursimi i tarifës së transportit

1. Tarifa e transportit paguhet paraprakisht përveç rastit të një marrëveshjeje ndryshe ndërmjet udhëtarit dhe transportuesit.

2. Organi kompetent përcakton kushtet e rimbursimit të tarifës së transportit.

Neni 4

E drejta e transportit dhe përgjegjësi nga transporti

1. Udhëtari që nga fillimi i udhëtimit duhet të ketë një biletë të vlefshme, ta ruajë, të mos e dëmtojë dhe ta paraqesë atë gjatë kontrollit të biletave. Organi kompetent përcakton rastet:

a) kur udhëtari nuk disponon biletë të vlefshme duhet të paguajë, përveç tarifës së transportit, një tarifë shtesë;

b) kur udhëtari refuzon të paguajë tarifën e transportit ose shtesën, sipas kërkesës mund t'i kërkohet të ndërpresë udhëtimin e tij;

c) nëse dhe në çfarë kushtesh do të bëhet pagesa e tarifës shtesë.

2. Organi kompetent parashikon për udhëtarët të cilët:

a) paraqesin rrezik për sigurinë dhe mirëfunksionimin e operimeve ose për sigurinë e udhëtarëve të tjerë;

b) bezdisin udhëtarët e tjerë në mënyrë të patolerueshme, përgjegjësinë ose ndërprerjen e udhëtimit të tyre nga transporti dhe se këta persona nuk kanë të drejtën e rimbursimit të tarifës së transportit ose të ndonjë tarife për transportin e bagazhit të regjistruar që mund të kenë paguar.

Neni 5

Zbatimi i formaliteteve administrative

Udhëtari respekton formalitetet e kërkuara nga doganat ose autoritetet e tjera administrative si dhe kur, gjatë transportit, ai ka sende (bagazh dore, bagazh të regjistruar, automjete përfshirë ngarkesat e tyre) ose kafshë. Ai mund të jetë i pranishëm në inspektimin e këtyre sendeve, me përgjegjësi të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligjet dhe rregullat e secilit shtet.

Neni 6

Anulimi dhe vonesa e trenave. Lidhjet e humbura

Transportuesi duhet, kur është e nevojshme, të vërtetojë në biletë se treni është anuluar, vonuar ose lidhja me trenat e tjerë të udhëtimit ka humbur.

TTULLI II

TRANSPORTI I BAGAZHEVE TË DORËS, KAFSHËVE DHE AUTOMJETEVE

KREU I

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 7

Artikuj dhe kafshë të lejueshme

1. Udhëtarit i lejohe të marrë me vete artikuj që trajtohen lehtësisht (bagazh dore), si dhe kafshë të gjalla, në përputhje me kushtet e pranimi për transport. Për më tepër, udhëtarit i lejohe të marrë me vete artikuj të rëndë, në përputhje me dispozitat e veçanta, të përfshira në kushtet e pranimi për transport. Artikujt dhe kafshët që paraqesin mundësi të shqetësojnë ose bezdisin udhëtarët ose të shkaktojnë dëme nuk lejohen si bagazh dore.

2. Udhëtarit i lejohe të dërgojë artikuj dhe kafshë si bagazh të regjistruar, në përputhje me kushtet e përgjithshme të transportit.

3. Transportuesi lejon transportin e mjeteve me rastin e transportit të udhëtarëve në përputhje me dispozitat e veçanta, të përfshira në kushtet e përgjithshme të transportit.

4. Transporti i mallrave të rrezikshme si bagazh dore, bagazh i regjistruar, si dhe brenda ose mbi automjete të cilat, në përputhje me këtë titull transportohen me hekurudhë, duhet të jetë në përputhje me Rregulloren në lidhje me Transportin e Mallrave të Rrezikshme me Hekurudhë (RID).

5. Është përgjegjësi e udhëtarit të mbikëqyrë bagazhin e dorës dhe kafshët që ai merr me vete.

Neni 8

Kontrolli

1. Kur ka arsye të forta për të dyshuar për mosrespektim të kushteve të transportit, transportuesi ka të drejtë të shqyrtojë nëse artikujt (bagazhet e dorës, bagazhet e regjistruara, automjetet duke përfshirë ngarkesat e tyre) dhe kafshët e transportuara janë në përputhje me kushtet e transportit, përveç rasteve kur ndalohet një ekzaminim i tillë. Udhëtari ftohet të marrë pjesë në kontroll. Nëse ai nuk paraqitet ose nuk mund të arrihet, transportuesi kërkon praninë e dy dëshmitarëve të pavarur.

2. Nëse konstatohet se nuk janë respektuar kushtet e transportit, transportuesi i kërkon udhëtarit të paguajë shpenzimet që rrjedhin nga kontrolli.

KREU II

REGJISTRIMI I BAGAZHEVE

Neni 9

Dërgimi i bagazhit të regjistruar

1. Detyrimet kontraktuale, në lidhje me dërgimin e bagazheve të regjistruara, përcaktohen nga një kupon regjistrimi i bagazhit të lëshuar për udhëtarin.

2. Në varësi të nenit 13, mungesa, parregullsia ose humbja e kuponit të regjistrimit të bagazheve nuk ndikon në ekzistencën ose vlefshmërinë e marrëveshjeve, në lidhje me dërgimin e bagazhit të regjistruar, të cilat mbeten subjekt i këtyre rregullave uniforme.

3. Kuponi i regjistrimit të bagazhit është dëshmi e regjistrimit të bagazhit dhe kushteve të transportit të saj.

4. Pa kundërshtuar kontestimet, kur transportuesi merr në dorëzim bagazhin e regjistruar, konsiderohet se ishte në dukje në gjendje të mirë dhe se numri dhe masa e sendeve të bagazhit korrespondonin me shënimet në kuponin e regjistrimit të bagazhit.

Neni 10

Kuponi për regjistrimin e bagazheve

1. Organi kompetent përcakton formën dhe përmbajtjen e kuponit të regjistrimit të bagazhit, si dhe gjuhën dhe karakteret në të cilat ai printohet. Sidoqoftë neni 2, pika 5 zbatohet gjithmonë.

2. Kuponi i regjistrimit të bagazhit përmban të paktën:
 - a) transportuesin ose transportuesit;
 - b) informacione për udhëtarin, destinacionin dhe bagazhin, dhe shërben si provë që bagazhi është kontrolluar, pavarësisht nga ndonjë klauzolë tjetër, kjo mund të tregohet me akronimin CIV;
 - c) çdo deklaratë tjetër e nevojshme për të vërtetuar detyrimet kontraktuale në lidhje me dërgimin e bagazhit të regjistruar dhe që i mundëson udhëtarit të kërkojë të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit.
3. Pas marrjes së kuponit të regjistrimit të bagazhit, udhëtari të sigurohet që është plotësuar në përputhje me udhëzimet e tij.

Neni 11

Regjistrimi, pagesa dhe transporti i bagazheve

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, bagazhi regjistrohet me prodhimin e një bilete të vlefshme të paktën deri në destinacionin e bagazhit. Në aspekte të tjera, regjistrimi i bagazheve do të kryhet në përputhje me rregullat në fuqi në vendin e dërgesës.
2. Kur parashikohet që bagazhet mund të pranohen për transport pa prodhimin e biletës, dispozitat e këtyre rregullave uniforme, që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e udhëtarit në lidhje me bagazhin e tij të regjistruar, zbatohen gjithmonë për dërguesin e bagazhit të regjistruar.
3. Transportuesi mund të përcjellë bagazhin e regjistruar me një tren tjetër ose me një mënyrë tjetër transporti dhe me rrugë të ndryshme nga ajo e udhëtarit.
4. Në varësi të një marrëveshjeje të kundërt ndërmjet udhëtarit dhe transportuesit, tarifa për transportin e bagazhit të regjistruar paguhet në regjistrim.
5. Udhëtari duhet të tregojë në një vend qartësisht të dukshëm të bagazhit të regjistruar, një artikull të lexueshëm dhe të qëndrueshëm që përmban:
 - a) emrin dhe adresën e tij;
 - b) vendin e destinacionit.

Neni 12

E drejta për të asgjësuar bagazhin e regjistruar

1. Udhëtari mund të marrë bagazhin në vendin e dërgimit nëse rrethanat e lejojnë dhe nëse kërkesat doganore ose kërkesat e autoriteteve të tjera administrative nuk shkelen në këtë mënyrë, me paraqitjen e kuponit të regjistrimit të bagazhit dhe biletës.
2. Kushtet e përgjithshme të transportit mund të përmbajnë dispozita të tjera në lidhje me të drejtën për të asgjësuar bagazhin e regjistruar, në veçanti modifikimet e vendit të destinacionit dhe pasojat e mundshme financiare që mund të përballohen nga udhëtari.

Neni 13

Dorëzimi

1. Bagazhi i regjistruar dorëzohet me dorëzimin e kuponit të regjistrimit të bagazhit dhe, sipas rastit, me faturën e pagesës.

Transportuesi ka të drejtë, por jo i detyruar, të shqyrtojë nëse mbajtësi i kuponit ka të drejtë të marrë dorëzimin.
2. Do të jetë e barabartë me dorëzimin të mbajtësi i kuponit të regjistrimit të bagazhit nëse, në përputhje me rregullat në fuqi në vendin e destinacionit:
 - a) bagazhi u është dorëzuar autoriteteve doganore ose tatimore në ambientet ose magazinat e tyre, kur këto nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes së transportuesit;
 - b) kafshët e gjalla u janë dorëzuar palëve të treta.

3. Mbajtësi i kuponit të regjistrimit të bagazhit mund të kërkojë dorëzimin e bagazhit në vendin e destinacionit sapo të ketë kaluar koha e rënë dakord dhe, sipas rastit, koha e nevojshme për operacionet e kryera nga doganat ose autoritetet e tjera administrative.

4. Në rast të mosdorëzimit të kuponit të regjistrimit të bagazhit, transportuesi është i detyruar t'ia dorëzojë bagazhin vetëm personit që vërteton të drejtën e tij; nëse prova e ofruar duket e pamjaftueshme, transportuesi mund të kërkojë dhënien e garancisë.

5. Bagazhi dorëzohet në vendin e destinacionit për të cilin është regjistruar.

6. Mbajtësi i kuponit të regjistrimit të bagazhit, bagazhi i të cilit nuk është dorëzuar, mund të kërkojë që dita dhe ora të regjistrohen në kupon kur ai ka kërkuar dorëzimin në përputhje me paragrafin 3.

7. Personi që ka të drejtë mund të refuzojë të pranojë bagazhin nëse transportuesi nuk përmbush kërkesën e tij për të kryer një ekzaminim të bagazhit të regjistruar për të vërtetuar dëmin e pretenduar.

8. Në të gjitha aspektet e tjera dorëzimi i bagazheve kryhet në përputhje me rregullat në fuqi në vendin e destinacionit.

KREU III AUTOMJETET

Neni 14 **Kushtet e transportit**

Dispozitat e veçanta që rregullojnë transportin e mjeteve automobilistike, të përfshira në kushtet e përgjithshme të transportit, specifikojnë veçanërisht kushtet që rregullojnë pranimin për transport, regjistrim, ngarkim dhe transport, shkarkim dhe dorëzim, si dhe detyrimet e udhëtarit.

Neni 15 **Kuponi i transportit për automjetet**

1. Detyrimet kontraktuale në lidhje me transportin e mjeteve përcaktohen nga një kupon transporti që i lëshohet udhëtarit. Kuponi i transportit mund të integrohet në biletën e udhëtarit.

2. Kushtet e veçanta që rregullojnë transportin e mjeteve automobilistike përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e kuponit të transportit, si dhe gjuhën dhe karakteret në të cilat ai printohet. Sidoqoftë neni 2, pika 5 zbatohet gjithmonë.

3. Në kuponin e transportit shënohen të paktën sa më poshtë:

- a) transportuesi ose transportuesit;
- b) informacione për udhëtarin, destinacionin dhe bagazhin, dhe shërben si provë që bagazhi është kontrolluar, pavarësisht nga ndonjë klauzolë tjetër, kjo mund të tregohet me akronimin CIV;
- c) çdo deklaratë tjetër e nevojshme për të vërtetuar detyrimet kontraktuale në lidhje me transportin e automjeteve dhe që i mundëson udhëtarit të kërkojë të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit.

4. Pas marrjes së kuponit të transportit, udhëtarit të sigurohet që ai të jetë bërë në përputhje me udhëzimet e tij.

5. Në varësi të dispozitave të këtij kreu, dispozitat e kreut II, në lidhje me transportin e bagazheve, do të zbatohen për automjetet.

TITULLI III PËRGJEGJËSIA E TRANSPORTUESIT

KREU I PËRGJEGJËSIA NË RAST TË VDEKJES OSE LËNDIMIT PERSONAL TË UDHËTARËVE

Neni 16

Baza e përgjegjësisë

1. Transportuesi është përgjegjës për humbjen ose dëmin që rezulton nga vdekja, lëndimet personale ose ndonjë dëm tjetër fizik ose mendor i një udhëtari, të shkaktuar nga një aksident që rrjedh nga funksionimi i hekurudhës dhe ndodh gjatë kohës që udhëtari është brenda, hipën ose zbret nga mjetet hekurudhore, pavarësisht nga infrastruktura hekurudhore e përdorur.

2. Transportuesi lirohet nga kjo përgjegjësi:

a) nëse aksidenti është shkaktuar nga rrethana që nuk lidhen me funksionimin e hekurudhës dhe të cilat transportuesi, pavarësisht nga kujdesi i kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk mundi t'i shmangte, dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte;

b) në masën që aksidenti është për shkak të fajit të udhëtarit;

c) nëse aksidenti është për shkak të sjelljes së një pale të tretë të cilën transportuesi, pavarësisht nga kujdesi i kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk mundi ta shmangte dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte; një sipërmarrje tjetër që përdor të njëjtën infrastrukturë hekurudhore nuk do të konsiderohet si palë e tretë; e drejta e rekursit nuk cenohet.

3. Nëse aksidenti është për shkak të sjelljes së një pale të tretë dhe nëse, pavarësisht kësaj, transportuesi nuk lirohet plotësisht nga përgjegjësia e tij, në përputhje me paragrafin 2, shkronja "c", ai do të jetë plotësisht përgjegjës deri në kufizimet e përcaktuara në këto rregulla, por pa paragjykuar çdo të drejtë rekursi që transportuesi mund të ketë kundër palës së tretë.

4. Këto rregulla nuk ndikojnë në asnjë detyrim që mund të lindë nga transportuesi në rastet që nuk parashikohen në paragrafin 1.

5. Nëse transporti kryhet nga transportues të njëpasnjëshëm, transportuesi i detyruar në përputhje me kontratën e transportit të ofrojë shërbimin e transportit gjatë të cilit ka ndodhur aksidenti, do të jetë përgjegjës në rast të vdekjes dhe lëndime personale të udhëtarëve. Kur ky shërbim nuk është ofruar nga transportuesi, por nga një transportues zëvendësues, të dy transportuesit do të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës në përputhje me këto rregulla.

Neni 17

Dëmet në rast vdekjeje

1. Në rast vdekjeje të udhëtarit, dëmet përfshijnë:

a) çdo kosto të nevojshme pas vdekjes, veçanërisht ato të transportit të trupit dhe shpenzimet e varrimit;

b) nëse vdekja nuk ndodh menjëherë, dëmshpërblimet e parashikuara në nenin 18.

2. Nëse, me vdekjen e udhëtarit, u hiqet mbështetja personave të cilëve ai kishte ose do të kishte detyrim ligjor t'i mbante, këta persona do të kompensohen edhe për atë humbje. Të drejtat e veprimit për dëmet e personave të cilët udhëtari i mbante pa qenë i detyruar ligjërisht për ta bërë këtë, rregullohen nga legjislacioni kombëtar.

Neni 18

Dëmet në rast lëndimi personal

1. Në rast dëmtimi personal ose ndonjë dëmtimi tjetër fizik ose mendor të udhëtarit, dëmet do të përfshijnë:

a) çdo kosto të nevojshme, veçanërisht ato të trajtimit dhe të transportit;

b) kompensim për humbjen financiare, për shkak të paaftësisë totale ose të pjesshme për punë, ose për shkak të nevojave të shtuara.

2. Përveç sa më sipër, transportuesi paguan dëmshpërblim për dëmtimin trupor sipas ligjeve në fuqi.

Neni 19

Forma dhe shuma e dëmshpërblimit në rast të vdekjes dhe lëndimit personal

1. Dëmet, sipas nenit 17, pikës 2 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, jepen në formën e një shume të madhe. Megjithatë, nëse ligji kombëtar lejon pagesën e një pensioni, dëmshpërblimi jepet në atë formë nëse kërkohet nga udhëtari i dëmtuar ose nga personat që kanë të drejtë të përmendur në nenin 17, pika 2.

2. Shuma e dëmit në paragrafin 1 përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar. Megjithatë, për qëllimet e këtyre rregullave, kufiri i sipërm për udhëtar do të vendoset në 175 000 njësi llogarie, si një shumë e përgjithshme ose si një pension vjetor që korrespondon me atë shumë, ku ligji kombëtar parashikon një kufi të sipërm më të vogël se ajo shumë.

Neni 20

Mënyra të tjera të transportit

1. Në varësi të paragrafit 2, dispozitat në lidhje me përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose dëmtimit personal të udhëtarëve nuk do të zbatohen për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar gjatë transportit, i cili, në përputhje me kontratën e transportit, nuk u transportua me hekurudhë.

2. Megjithatë, kur mjetet hekurudhore transportohen me traget, dispozitat në lidhje me përgjegjësinë në rast vdekjeje ose dëmtimi personal të udhëtarëve zbatohen për humbjen ose dëmtimin e përmendur në nenin 16, pika 1 dhe në nenin 22, pika 1, të shkaktuar nga një aksident që vjen nga funksionimi i hekurudhës dhe ndodh kur udhëtari është brenda, duke hyrë ose duke zbritur nga mjetet e përmendura.

3. Kur, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, funksionimi i hekurudhës pezullohet përkohësisht dhe udhëtarët transportohen me një mënyrë tjetër transporti, transportuesi është përgjegjës në përputhje me këto rregulla.

KREU II

PËRGJEGJËSIA NË RAST MOSRESPEKTIMI TË ORARIT

Neni 21

Përgjegjësia në rast anulimi, vonese të trenave ose lidhjeve të humbura

1. Transportuesi është përgjegjës ndaj udhëtarit për humbjen ose dëmin që rezulton nga fakti se, për shkak të anulimit, vonesës së një treni ose lidhjes së humbur, udhëtimi i tij nuk mund të vazhdojë në të njëjtën ditë, ose që një vazhdim i udhëtimit në të njëjtën ditë nuk mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme për shkak të rrethanave të caktuara. Dëmet përfshijnë kostot e arsyeshme të akomodimit, si dhe kostot e arsyeshme të shkaktuara nga detyrimi për të njoftuar personat që presin udhëtarin.

2. Transportuesi lirohet nga kjo përgjegjësi, kur anulimi, vonesa ose lidhja e humbur i atribuohet një prej shkaqeve të mëposhtme:

a) rrethanat që nuk lidhen me funksionimin e hekurudhës, të cilat transportuesi, pavarësisht nga kujdesi i kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk mundi t'i shmangte dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte;

b) faji i udhëtarit; ose

c) sjelljen e një pale të tretë, të cilën transportuesi, pavarësisht nga kujdesi i kërkuar në rrethanat e veçanta të rastit, nuk mund ta shmangte dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte; një sipërmarrje tjetër që përdor të njëjtën infrastrukturë hekurudhore nuk do të konsiderohet si palë e tretë; e drejta e rekursit nuk cenohet.

3. Ligji kombëtar përcakton nëse dhe në çfarë mase transportuesi paguan dëmshpërblim për dëm të ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin 1. Kjo dispozitë nuk cenon nenin 33.

KREU III
PËRGJEGJËSIA NË LIDHJE ME BAGAZHET E DORËS, KAFSHËT, BAGAZHET E
REGJISTRUARA DHE AUTOMJETET

SEKSIONI 1
BAGAZHET E DORËS DHE KAFSHËT

Neni 22
Përgjegjësia

1. Në rast të vdekjes ose lëndimit personal të udhëtarëve, transportuesi është gjithashtu përgjegjës për humbjen ose dëmin që rezulton nga humbja e plotë ose e pjesshme, ose dëmtimi i artikujve që udhëtari kishte në dorë ose me vete si bagazhe; kjo vlen edhe për kafshët që udhëtari i kishte sjellë me vete. Neni 16 zbatohet pavarësisht rrethanave.

2. Në aspekte të tjera, transportuesi nuk është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të artikujve, bagazheve të dorës ose kafshëve, mbikëqyrja e të cilave është përgjegjësi e udhëtarit, në përputhje me nenin 5, pika 2, përveç rasteve kur kjo humbje ose dëm shkaktohet nga faji i transportuesit. Nenet e tjera të titullit III, me përjashtim të nenit 39, dhe të titullit V nuk do të zbatohen në këtë rast.

Neni 23
Kufiri i dëmeve në rast të humbjes ose dëmtimit të artikujve

Kur transportuesi është përgjegjës sipas nenit 22, pika 1, ai duhet të paguajë kompensim deri në një kufi prej 1 400 njësi llogarie për udhëtar.

Neni 24
Përjashtimi i përgjegjësisë

Transportuesi nuk është përgjegjës ndaj udhëtarit për humbjet ose dëmtimet që rrjedhin nga fakti që udhëtari nuk është në përputhje me formalitetet e kërkuara nga doganat ose autoritetet e tjera administrative.

SEKSIONI 2
BAGAZHI I REGJISTRUAR

Neni 25
Baza e përgjegjësisë

1. Transportuesi është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin që rezulton nga humbja e plotë ose e pjesshme, ose dëmtimi i bagazhit të regjistruar ndërmjet kohës së marrjes në dorëzim nga transportuesi dhe kohës së dorëzimit, si dhe nga vonesa në dorëzim.

2. Transportuesi lirohet nga kjo përgjegjësi për aq sa humbja, dëmtimi ose vonesa në dorëzim është shkaktuar nga faji i udhëtarit, me një urdhër të dhënë nga udhëtari, përveçse si rezultat i fajit të transportuesit nga një defekt i lindur në bagazhin e regjistruar ose nga rrethana të cilat transportuesi nuk mundi t'i shmangte dhe pasojat e të cilave ai nuk ishte në gjendje t'i parandalonte.

3. Transportuesi lirohet nga kjo përgjegjësi në masën që humbja ose dëmtimi lind nga rreziqet e veçanta të qenësishme në një ose më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

- a) mungesa ose pamjaftueshmëria e paketimit;
- b) natyra e veçantë e bagazhit;
- c) dërgesa si bagazh i artikujve të papranueshëm për transport.

Neni 26
Barra e provës

1. Barra e provës se humbja, dëmtimi ose vonesa në dorëzim ka ardhur për shkak të një prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 25, pika 2, i bie transportuesit.

2. Kur transportuesi konstaton se, duke pasur parasysh rrethanat e një rasti të caktuar, humbja ose dëmtimi mund të ketë ardhur nga një ose më shumë nga rreziqet e veçanta të përmendura në nenin 25, pika 3, do të supozohet se kështu ka ndodhur. Megjithatë, udhëtari ka të drejtën të provojë se humbja ose dëmi nuk i atribuohen tërësisht ose pjesërisht njërit prej këtyre rreziqeve.

Neni 27
Transportuesit e njëpasnjëshëm

Nëse transporti kryhet nga disa transportues të njëpasnjëshëm, çdo transportues, me vetë aktin e marrjes në dorëzim të bagazhit me kuponin e regjistrimit të bagazhit ose automjetin me kuponin e transportit, bëhet palë në lidhje me dërgimin e bagazheve ose të transportit të automjeteve, në përputhje me kushtet e kuponit të regjistrimit të bagazhit ose të kuponit të transportit dhe merr përsipër detyrimet që rrjedhin prej tyre. Në këtë rast, çdo transportues është përgjegjës për transportin në të gjithë itinerarin deri në dorëzim.

Neni 28
Transportues zëvendësues

1. Kur transportuesi i ka besuar kryerjen e transportit, tërësisht ose pjesërisht, një transportuesi zëvendësues, pavarësisht nëse është ose jo në zbatim të një të drejte sipas kontratës së transportit për ta bërë këtë, transportuesi mbetet përgjegjës në lidhje me të gjithë ngarkesën.

2. Të gjitha dispozitat e këtyre rregullave që rregullojnë përgjegjësinë e transportuesit zbatohen edhe për përgjegjësinë e transportuesit zëvendësues për transportin e kryer prej tij. Nenet 36 dhe 40 zbatohen nëse një padi ngrihet kundër nëpunësve ose çdo personi tjetër, shërbimet e të cilëve transportuesi zëvendësues i përdor për kryerjen e transportit.

3. Çdo marrëveshje e veçantë, sipas së cilës transportuesi merr përsipër detyrime që nuk imponohen nga këto rregulla ose heq dorë nga të drejtat e dhëna nga këto rregulla, nuk do të ketë asnjë efekt në lidhje me transportuesin zëvendësues i cili nuk e ka pranuar atë shprehimisht dhe me shkrim. Pavarësisht nëse transportuesi zëvendësues e ka pranuar apo jo atë, transportuesi megjithatë do të mbetet i detyruar nga detyrimet ose heqjet dorë që rrjedhin nga një marrëveshje e tillë speciale.

4. Kur dhe në masën që si transportuesi ashtu edhe transportuesi zëvendësues janë përgjegjës, përgjegjësia e tyre është solidare.

5. Shuma totale e kompensimit që paguhet nga transportuesi, transportuesi zëvendësues dhe personat e tjerë, shërbimet e të cilëve u përdorën për kryerjen e transportit nuk duhet të kalojë kufijtë e parashikuar në këto rregulla.

6. Ky nen nuk cenon të drejtat e rekursit që mund të ekzistojnë ndërmjet transportuesit dhe transportuesit zëvendësues.

Neni 29
Prezumimi i humbjes

1. Udhëtari mundet, pa i kërkuar të japë prova të mëtejshme, të konsiderojë një bagazh të humbur kur nuk është dorëzuar ose vënë në dispozicion të tij brenda 14 ditëve pasi është bërë një kërkesë për dorëzim, në përputhje me nenin 13, pika 3.

2. Nëse një bagazh i konsideruar i humbur rikthehet brenda një viti pas kërkesës për dorëzim, transportuesi njofton personin që ka pasur bagazhin nëse adresa e tij dihet ose mund të konstatohet.

3. Brenda tridhjetë ditëve pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin 2, personi që ka pasur bagazhin mund të kërkojë t'i dorëzohet bagazhi. Në këtë rast ai duhet të paguajë tarifën duke përfshirë çdo kosto tjetër, në lidhje me transportin e sendit apo bagazhit nga vendi i dërgesës në vendin ku kryhet dorëzimi dhe të kthejë kompensimin e marrë më parë. Megjithatë, ai do të ruajë të drejtat e tij për të kërkuar kompensim për vonesën e dorëzimit të parashikuar në nenin 32.

4. Nëse bagazhi i rikuperuar nuk është kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 3 ose nëse është rikuperuar më shumë se një vit pas kërkesës për dorëzim, transportuesi e disponon atë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Neni 30

Kompensimi për humbjen

1. Në rast të humbjes së plotë ose të pjesshme të bagazhit të regjistruar, transportuesi paguan, duke përjashtuar të gjitha dëmet e tjera:

a) nëse vërtetohet shuma e humbjes ose dëmit të pësuar, kompensim i barabartë me atë shumë, por jo më shumë se 80 njësi llogarie për kilogram bruto ose 1 200 njësi llogarie për artikull bagazh;

b) nëse shuma e humbjes ose dëmit të pësuar nuk përcaktohet, dëmet likuidohen prej 20 njësi llogarie për kilogram bruto ose 300 njësi llogarie për artikull bagazh.

Mënyra e kompensimit, sipas kilogramëve të humbur ose sipas bagazhit, përcaktohet nga Kushtet e Përgjithshme të Transportit.

2. Transportuesi rimburson gjithashtu tarifën për transportin e bagazhit dhe shumat e tjera të paguara në lidhje me transportin e sendit të humbur, si dhe detyrimet doganore dhe akcizat e paguara tashmë.

Neni 31

Kompensimi për dëmin

1. Në rast dëmtimi të bagazhit të regjistruar, transportuesi duhet të paguajë kompensim të barabartë me humbjen në vlerë të bagazhit, duke përjashtuar të gjitha dëmtimet e tjera.

2. Kompensimi nuk duhet të kalojë:

a) nëse i gjithë bagazhi ka humbur vlerën për shkak të dëmtimit, shuma që do të ishte e pagueshme në rast të humbjes totale;

b) nëse vetëm një pjesë e bagazhit ka humbur vlerën për shkak të dëmtimit, shuma që do të ishte e pagueshme nëse ajo pjesë do të kishte humbur.

Neni 32

Kompensimi për vonesën në dorëzim

1. Në rast vonese në dorëzimin e bagazhit të regjistruar, transportuesi paguan për çdo periudhë të plotë prej 24 orësh pasi është kërkuar dërgesa, por me një maksimum prej 14 ditësh:

a) nëse personi që ka bagazhin provon se humbja ose dëmi është pësuar nga kjo, kompensimi është i barabartë me shumën e humbjes ose dëmit, deri në maksimum 0,80 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazhit ose 14 njësi llogarie për bagazhin e dorëzuar me vonesë;

b) nëse personi që ka bagazhin nuk provon se është pësuar humbje ose dëmtim, likuidohen dëmet prej 0,14 njësi llogarie për kilogram të masës bruto të bagazhit ose 2,80 njësi llogarie për artikull bagazhi, të dorëzuara me vonesë.

Metodat e kompensimit, sipas kilogramëve të humbur ose sipas bagazhit, përcaktohen nga Kushtet e Përgjithshme të Transportit.

2. Në rast të humbjes totale të bagazhit, kompensimi i parashikuar në pikën 1 nuk paguhet përveç atij të parashikuar në nenin 30.

3. Në rast të humbjes së pjesshme të bagazhit, kompensimi i parashikuar në paragrafin 1 do të paguhet për atë pjesë të bagazhit që nuk ka humbur.

4. Në rast dëmtimi të bagazhit që nuk rezulton nga vonesa në dorëzim, kompensimi i parashikuar në paragrafin 1, sipas rastit, do të paguhet, përveç atij të parashikuar në nenin 31.

5. Në asnjë rast totali i kompensimit të parashikuar në paragrafin 1 së bashku me atë të pagueshëm sipas neneve 30 dhe 31 nuk do të kalojë kompensimin që paguhet në rast të humbjes totale të bagazhit.

SEKSIONI 3 AUTOMJETET

Neni 33

Kompensimi për vonesën

1. Në rast vonese në ngarkim për një arsye që i atribuohet transportuesit ose vonese në dorëzimin e një automjeti, transportuesi, nëse pronari i bagazhit provon se është pësuar humbje ose dëmtim, duhet të paguajë kompensim që nuk e kalon shumën e tarifës së transportit.

2. Nëse, në rast vonese në ngarkim për një arsye që i atribuohet transportuesit, pronari i bagazhit zgjedh të mos vazhdojë me kontratën e transportit, i kthehet tarifa e transportit. Përveç kësaj, pronari i bagazhit, nëse provon se ka pësuar humbje ose dëmtim si rezultat i vonesës, mund të kërkojë kompensim që nuk e kalon shumën e tarifës së transportit.

Neni 34

Kompensimi për humbjen

Në rast të humbjes së plotë ose të pjesshme të një automjeti, kompensimi që i paguhet personit të autorizuar për humbjen ose dëmin e provuar llogaritet në bazë të vlerës së zakonshme të mjetit. Nuk duhet të kalojë 8 000 njësi llogarie. Një rimorkio me ngarkesë ose bosh konsiderohet si mjet i veçantë.

Neni 35

Përgjegjësia në lidhje me artikujt e tjerë

1. Në lidhje me artikujt brenda automjetit ose të vendosura në kuti (p.sh. kuti bagazhesh ose kuti skish) të fiksuar në mjet, transportuesi është përgjegjës vetëm për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar nga faji i tij. Kompensimi total i pagueshëm nuk kalon 1 400 njësi llogarie.

2. Për sa i përket artikujve të vendosur në pjesën e jashtme të mjetit, duke përfshirë kutitë e përmendura në paragrafin 1, transportuesi mban përgjegjësi vetëm nëse provohet se humbja ose dëmtimi u shkaktuan nga një veprim ose mosveprim i transportuesit, me qëllim për të shkaktuar dëme, ose në mënyrë të pakujdesshme dhe duke e ditur se një humbje ose dëmtim i tillë mund të ndodhë.

3. Në varësi të dispozitave të këtij seksioni, dispozitat e seksionit 2, në lidhje me përgjegjësinë për bagazhet, zbatohen për automjetet.

KREU IV DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 36

Kufizimi i përgjegjësisë

Kufijtë e përgjegjësive të parashikuara në këto rregulla, si dhe dispozitat ligjore në fuqi, të cilat kufizojnë kompensimin në një shumë fikse, nuk zbatohen nëse vërtetohet se humbja ose dëmtimi rezulton nga një veprim ose mosveprim, të cilin transportuesi ka kryer ose me qëllim për të shkaktuar një humbje ose dëmtim të tillë, ose në mënyrë të pakujdesshme dhe me dijeni se një humbje ose dëmtim i tillë ka të ngjarë të ndodhë.

Neni 37

Konvertimi dhe interesi

1. Kur llogaritja e kompensimit kërkon konvertimin e shumave të shprehura në valutë të huaj, konvertimi bëhet me kursin e këmbimit të zbatueshëm në ditën dhe në vendin e pagesës së kompensimit.

2. Pronari i bagazhit mund të kërkojë kamatë kompensimi, të llogaritur në masën pesë për qind në vit, nga dita e kërkesës së parashikuar në nenin 43 ose, nëse nuk është bërë një kërkesë e tillë, nga dita në të cilën është nisur procedimi gjyqësor.

3. Megjithatë, në rastin e kompensimit të pagueshëm sipas neneve 17 dhe 18, interesi rritet vetëm nga dita në të cilën kanë ndodhur ngjarjet që kanë lidhje me vlerësimin e shumës së kompensimit, nëse ajo ditë është më vonë se ajo e kërkesës ose ditën kur është nisur procedura gjyqësore.

4. Në rastin e bagazheve, interesi paguhet vetëm nëse kompensimi tejkalon 16 njësi llogarie për kupon të regjistrimit të bagazhit.

5. Në rastin e bagazhit, nëse pronari i bagazhit nuk i dorëzon transportuesit, brenda një kohe të arsyeshme të caktuar, dokumentet mbështetëse që kërkohen që shuma të shlyhet përfundimisht, nuk rritet interesi ndërmjet skadimit të afatit dhe dorëzimit aktual të këtyre dokumenteve.

Neni 38

Përgjegjësia në rast incidentesh bërthamore

Transportuesi lirohet nga përgjegjësia në përputhje me këto rregulla për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar nga një incident bërthamor, kur operatori i një instalimi bërthamor ose një person tjetër që ka zëvendësuar atë është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin, në përputhje me ligjet dhe përshkrimet që rregullojnë përgjegjësinë në fushën e energjisë bërthamore.

Neni 39

Personat për të cilët transportuesi është përgjegjës

Transportuesi është përgjegjës për nëpunësit e tij dhe personat e tjerë, shërbimet e të cilëve ai i përdor për kryerjen e transportit, kur këta nëpunës dhe persona të tjerë veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre. Administratorët e infrastrukturës hekurudhore në të cilën kryhet transporti konsiderohen si persona shërbimet e të cilëve transportuesi i përdor për kryerjen e transportit.

Neni 40

Veprime të tjera

1. Në të gjitha rastet kur zbatohen këto rregulla, çdo veprim në lidhje me përgjegjësinë, mbi çfarëdo arsye, mund të ngrihet kundër transportuesit vetëm duke iu nënshtruar kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në këto rregulla.

2. E njëjta gjë do të zbatohet për çdo padi të ngritur kundër nëpunësve dhe personave të tjerë për të cilët transportuesi është përgjegjës në përputhje me nenin 39.

TITULLI IV PËRGJEGJËSIA E UDHËTARIT

Neni 41

Parimet e veçanta të përgjegjësisë

Udhëtari është përgjegjës ndaj transportuesit për çdo humbje ose dëmtim:

a) që rezulton nga mospërmbyshja e detyrimeve të tij në përputhje me:

1. nenin 5 dhe nenin 11, pika “b”;

2. dispozitat e veçanta për transportin e automjeteve, të përfshira në Kushtet e Përgjithshme të Transportit; ose

3. Rregullorja në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me hekurudhë (RID); ose

b) shkaktuar nga artikujt dhe kafshët që ai sjell me vete,

me përjashtim të rastit kur provon se humbja ose dëmtimi ishte shkaktuar nga rrethana që ai nuk mundi t'i shmangte dhe pasojat e të cilave nuk ishte në gjendje t'i parandalonte, pavarësisht se ai zbatoi rregullat e kërkuara si një udhëtar i ndërgjegjshëm.

Kjo dispozitë nuk do të ndikojë në përgjegjësinë e transportuesit, në përputhje me nenin 16 dhe pikën 1, të nenit 22.

TITULLI V

KUFIZIMI I TË DREJTAVE

Neni 42

Konstatimi i humbjes ose dëmtimit të pjesshëm

1. Kur humbja e pjesshme ose dëmtimi i një artikulli si (bagazhe, automjete) zbulohet ose supozohet nga transportuesi, ose pretendohet nga pronari i bagazhit, transportuesi pa vonesë, dhe nëse është e mundur në praninë e pronarit të bagazhit, harton një raport që tregon, sipas natyrës së humbjes ose dëmtimit, gjendjen e artikullit dhe, për aq sa është e mundur, shkallën e humbjes ose dëmtimit, shkaku dhe kohën e shfaqjes së tij.

2. Një kopje e raportit i jepet pa pagesë pronarit të bagazhit.

3. Nëse pronari i bagazhit nuk pranon përmbajtjen e raportit, ai kërkon shqyrtimin nga një ekspert i caktuar nga palët në kontratën e transportit ose ankohet në gjykatë. Procedura që ndiqet rregullohet nga ligjet dhe rregullat në fuqi.

Neni 43

Pretendimet

1. Pretendimet në lidhje me përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose lëndimit personal të udhëtarëve i drejtohen me shkrim transportuesit kundër të cilit ngrihet padi. Në rastin e një transporti të drejtuar nga një kontratë e vetme dhe të kryer nga transportues të njëpasnjëshëm, pretendimet mund t'i drejtohen gjithashtu transportuesit të parë ose të fundit, si dhe transportuesit që ka vendin e tij kryesor të biznesit ose agjencisë që ka lidhur kontratën e transportit.

2. Pretendimet e tjera në lidhje me kontratën e transportit i drejtohen me shkrim transportuesit të specifikuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 44.

3. Dokumentet që personi paditës mendon se janë të përshtatshme të paraqesë bashkëngjitur me kërkesën, paraqiten në origjinal ose në kopje të vërtetuara sipas kërkesave të transportuesit. Pas zgjidhjes së kërkesës, transportuesi mund të kërkojë dorëzimin e biletës, kuponin e regjistrimit të bagazhit dhe kuponin e transportit.

Neni 44

Transportuesit kundër të cilëve mund të ngrihet padi

1. Një padi e bazuar në përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose lëndimit personal të udhëtarëve ngrihet vetëm kundër transportuesit, i cili është përgjegjës në përputhje me nenin 16, pika 5.

2. Në varësi të paragrafit 4, padi të tjera të ngritura nga udhëtarët në bazë të kontratës së transportit ngrihen vetëm kundër transportuesit të parë, transportuesit të fundit ose transportuesit që ka kryer pjesën e transportit në të cilën ka ndodhur ngjarja që ka shkaktuar procedimin.

3. Kur në rastin e transportit të kryer nga transportues të njëpasnjëshëm, transportuesi që duhet të dorëzojë bagazhin ose mjetin është futur me pëlqimin e tij në kuponin e regjistrimit të bagazhit ose në kuponin e transportit, kundër tij ngrihet padi në përputhje me paragrafin 2 edhe nëse nuk e ka marrë bagazhin ose mjetin.

4. Padia për rikuperimin e një shume të paguar në bazë të kontratës së transportit ngrihet kundër transportuesit që e ka mbledhur atë shumë ose kundër transportuesit në emër të të cilit është mbledhur.

5. Një padi mund të ngrihet kundër një transportuesi të ndryshëm nga ata të specifikuar në paragrafët 2 dhe 4, kur ngrihet me anë të kundërpadisë ose me përjashtim në procedurat në lidhje me një pretendim kryesor të bazuar në të njëjtën kontratë transporti.

6. Në masën që këto rregulla zbatohen për transportuesin zëvendësues, një padi ngrihet edhe kundër tij.

7. Nëse paditësi ka një zgjedhje midis disa transportuesve, e drejta e tij për të zgjedhur shuhet sapo të ngrejë padi kundër njërit prej tyre; kjo zbatohet gjithashtu nëse paditësi ka një zgjedhje midis një ose më shumë transportuesve dhe një transportuesi zëvendësues.

Neni 45

Shuarja e së drejtës së veprimit në rast vdekjeje ose dëmtimi personal

1. Në rast të vdekjes ose dëmtimit personal të udhëtarëve, çdo e drejtë veprimi nga paditësi shuhet nëse nuk bëhet njoftimi për aksidentin brenda 12 muaj pasi ai ka marrë dijëni për humbjen ose dëmtimin, tek një prej transportuesve të cilit i drejtohet një kërkesë, në përputhje me nenin 43, pika 1. Kur paditësi e njofton transportuesin me gojë për aksidentin, transportuesi duhet t'i japë atij një konfirmim të një njoftimi të tillë gojor.

2. Megjithatë, e drejta e veprimit nuk shuhet nëse:

a) brenda periudhës së parashikuar në paragrafin 1, paditësi i është drejtuar me një pretendim njërit prej transportuesve të përcaktuar në nenin 43, pika 1;

b) brenda periudhës së parashikuar në paragrafin 1, transportuesi i cili është përgjegjës ka mësuar për aksidentin e udhëtarit në ndonjë mënyrë tjetër;

c) njoftimi për aksidentin nuk është dhënë, ose është dhënë me vonesë, si rezultat i rrethanave që nuk i atribuohen paditësit;

ç) paditësi provon se aksidenti është shkaktuar nga faji i transportuesit.

Neni 46

Shuarja e së drejtës së veprimit në rast humbjeje apo dëmtimi të bagazheve

1. Pranimi i bagazhit nga pronari shuan të gjitha të drejtat e veprimit kundër transportuesit që rrjedhin nga kontrata e transportit në rast të humbjes së pjesshme, dëmtimit ose vonesës në dorëzim.

2. Megjithatë, e drejta e veprimit nuk shuhet:

a) në rast të humbjes ose dëmtimit të pjesshëm, nëse:

1. humbja ose dëmtimi është konstatuar në përputhje me nenin 42 para pranimit të bagazhit nga pronari i bagazhit;

2. konstatimi i cili duhet të ishte kryer, në përputhje me nenin 42, është hequr vetëm për fajin e transportuesit;

b) në rast humbjeje ose dëmtimi që nuk është i dukshëm, ekzistenca e të cilit konstatohet pas pranimit të bagazhit nga pronari, nëse ai:

1. kërkon konstatimin në përputhje me nenin 42, menjëherë pas zbulimit të humbjes ose dëmtimit dhe jo më vonë se tre ditë pas pranimit të bagazhit; dhe

2. përveç kësaj, vërteton se humbja ose dëmtimi ka ndodhur ndërmjet kohës së marrjes në dorëzim nga transportuesi dhe kohës së dorëzimit;

c) në rast vonese në dorëzim, nëse pronari i bagazhit, brenda njëzet e një ditësh, ka kërkuar të drejtat e tij kundër njërit prej transportuesve të specifikuar në nenin 44, pika 3;

ç) nëse pronari i bagazhit provon se humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga faji i transportuesit.

Neni 47

Kufizimi i veprimeve

1. Periudha e kufizimit të veprimeve për dëmshpërblim, bazuar në përgjegjësinë e transportuesit në rast të vdekjes ose dëmtimit personal të udhëtarëve, do të jetë:

a) në rastin e një udhëtari, tre vjet nga e nesërmja e aksidentit;

b) në rastin e personave të tjerë që kanë të drejtë ligjore për kërkimin e dëmshpërblimit, tre vjet nga e nesërmja e vdekjes së udhëtarit, me një maksimum prej pesë vjetësh nga e nesërmja e aksidentit.

2. Afati i parashkrimit për veprimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e transportit është një vit. Megjithatë, periudha e parashkrimit do të jetë dy vjet në rastin e një veprimi për humbje ose dëmtim që rezulton nga një veprim ose mosveprim i kryer ose me qëllim për të shkaktuar një humbje ose dëmtim të tillë, ose me pakujdesi dhe me dijeninë se një humbje ose dëmtim i tillë ka të ngjarë rezultat.

3. Periudha e kufizimit të parashikuar në paragrafin 2 do të zbatohet për veprimet:

a) për kompensimin e humbjes totale, nga dita e katërmbëdhjetë pas skadimit të periudhës kohore të parashikuar në nenin 13, pika 3;

b) për kompensim për humbje të pjesshme, dëmtim ose vonesë në dorëzim, nga dita kur ka ndodhur dorëzimi;

c) në të gjitha rastet e tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve, nga dita e skadimit të vlefshmërisë së biletës.

Dita e treguar për fillimin e periudhës së parashkrimit nuk do të përfshihet në periudhë.

4. Përndryshe, pezullimi dhe ndërprerja e periudhave të parashkrimit rregullohet nga ligjet në fuqi.

TITULLI VI

MARRËDHËNIET MIDIS TRANSPORTUESVE

Neni 48

Ndarja e tarifës së transportit

1. Çdo transportues që mbledh një tarifë transporti ju pagan transportuesve përkatës pjesën e tyre të tarifës. Mënyrat e pagesës caktohen me marrëveshje ndërmjet transportuesve.

2. Për marrëdhëniet ndërmjet transportuesve të njëpasnjëshëm zbatohen gjithashtu neni 1, pika 3 dhe neni 9, pika 3.

Neni 49

E drejta e rekursit

1. Një transportues i cili ka paguar kompensim në përputhje me këto rregulla ka të drejtën e rekursit kundër transportuesve që kanë marrë pjesë në transport, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

- a) transportuesi që ka shkaktuar humbjen ose dëmtimin është i vetëm përgjegjës për të;
- b) kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga disa transportues, secili do të jetë përgjegjës për humbjen ose dëmin që ka shkaktuar; nëse një dallim i tillë është i pamundur, kompensimi do të ndahet ndërmjet tyre në përputhje me shkronjën “c”;
- c) nëse nuk mund të vërtetohet se cili nga transportuesit ka shkaktuar humbjen ose dëmin, kompensimi do të ndahet midis të gjithë transportuesve që kanë marrë pjesë në transport, përveç atyre që provojnë se humbja ose dëmi nuk është shkaktuar prej tyre; një ndarje e tillë do të jetë në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tarifës së transportit.

2. Në rastin e falimentimit të secilit prej këtyre transportuesve, pjesa e papaguar që i takon atij do të ndahet midis të gjithë transportuesve të tjerë që kanë marrë pjesë në transport, në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tarifës së transportit.

Neni 50

Procedura e rekursit

1. Nëse një transportues ushtron të drejtën e rekursit kundër një transportuesi tjetër sipas nenit 49 dhe kompensimi është përcaktuar nga një gjykatë, transportuesi kundër të cilit ushtrohet e drejta për rekurs nuk mund të kundërshtojë vlefshmërinë e pagesës. Gjykata i jep mundësi transportuesit nëpërmjet njoftimit dhe kohës së nevojshme për ndërhyrje në procedurë.

2. Transportuesi që ushtron të drejtën e tij të rekursit duhet të paraqesë kërkesën e tij në të njëjtën procedurë kundër të gjithë transportuesve me të cilët ai nuk ka arritur marrëveshje, në rast të kundërt ai humbet të drejtën e tij të rekursit.

3. Gjykata jep vendimin e saj në të njëjtin vendim për të gjitha kërkesat për rekurs të paraqitura para saj.

4. Transportuesi që dëshiron të zbatojë të drejtën e tij të rekursit mund të ngrejë padinë e tij në gjykatën në territorin e të cilit njëri nga transportuesit pjesëmarrës në transport ka vendin kryesor të biznesit të tij ose degën, ose agjencinë që ka përfunduar kontrata e transportit.

5. Kur padia ngrihet kundër disa transportuesve, transportuesi paditës ka të drejtë të zgjedhë gjykatën në të cilin ngre procedimin midis atyre që kanë kompetencë sipas paragrafit 4.

6. Procedurat e rekursit nuk mund të bashkohen me procedurat për dëmshpërblim të marra nga personi që ka të drejtë ligjore dëmshpërblimi sipas kontratës së transportit.

Neni 51

Marrëveshjet në lidhje me rekursin

Transportuesit mund të lidhin marrëveshje që shmangin nenet 48 dhe 49.

ANEKSI III

INFORMACION MINIMAL QË DUHET TË SIGUROHET NGA SIPËRMARRJET HEKURUDHORE DHE/OSE NGA SHITËSIT E BILETAVE

1. Informacion para udhëtimit

- Kushtet e përgjithshme të zbatueshme për kontratën;
- Oraret dhe kushtet për udhëtimin më të shpejtë;
- Oraret dhe kushtet për të gjitha tarifat e disponueshme, duke theksuar tarifat më të ulëta;
- Aksesueshmëria, kushtet e aksesit dhe disponueshmëria në bordin e objekteve për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar;
- Disponueshmëria e kapacitetit dhe kushtet e aksesit për biçikletat;
- Disponueshmëria e sediljeve në klasën e parë dhe të dytë, si dhe vagonët e gjumit;

- Ndërprerje dhe vonesa (të planifikuara dhe në kohë reale);
- Disponueshmëria e objekteve në tren, duke përfshirë *wi-fi* dhe tualetet, dhe e shërbimeve në tren, duke përfshirë ndihmën me të cilën udhëtarët ofrohen nga stafi;
- Informacioni përpara blerjes, nëse bileta ose biletat përbëjnë një biletë;
- Procedurat për rikuperimin e bagazheve të humbura;
- Procedurat për paraqitjen e ankesave.

2. Informacion gjatë udhëtimit

- Shërbime dhe lehtësira në tren, duke përfshirë *wi-fi*;
- Stacioni tjetër;
- Ndërprerje dhe vonesa (të planifikuara dhe në kohë reale);
- Shërbimet kryesore lidhëse;
- Çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë.

3. Operacionet në lidhje me sistemet e rezervimeve

- Kërkesat për disponueshmërinë e shërbimeve të transportit hekurudhor, duke përfshirë tarifatat e aplikueshme;
- Kërkesat për rezervimin e shërbimeve të transportit hekurudhor;
- Kërkesat për anulim të pjesshëm ose të plotë të një rezervimi.

ANEKSI IV STANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT

Informacion dhe bileta

Përpikëria e shërbimeve dhe parimet e përgjithshme për të përballuar ndërprerjet e shërbimeve.

Vonesat:

- i. vonesa mesatare e përgjithshme e shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike);
- ii. përqindja e vonesave të shkaktuara nga rrethanat e përmendura në pikën 10, të nenit 20 të udhëzimit;
- iii. përqindja e shërbimeve të vonuara në nisje;
- iv. përqindja e shërbimeve të vonuara në mbërritje:
 - përqindja e vonesave më pak se 60 minuta;
 - përqindja e vonesave 60–119 minuta;
 - përqindja e vonesave prej 120 minutash ose më shumë.

Anulimet e shërbimeve:

- i. anulimi i shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (ndërkombëtar, vendës në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike);
- ii. anulimi i shërbimeve si përqindje për kategori shërbimi (ndërkombëtar, vendës në distanca të gjata, rajonale dhe urbane/periferike) të shkaktuara nga rrethanat e përmendura në pikën 10, të nenit 20 të udhëzimit.

Pastërtia e mjeteve hekurudhore dhe objekteve të stacioneve (kontrolli i cilësisë së ajrit dhe temperaturës në vagonë, higjiena e objekteve sanitare etj.).

Anketa e cilësisë së shërbimeve të klientit.

Trajtimi i ankesave, rimbursimet dhe kompensimi për mospërputhje me standardet e cilësisë së shërbimit.

Ndihma e ofruar për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, dhe diskutime në lidhje me këtë ndihmë me organizata përfaqësuese dhe, sipas rastit, përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar.